



**KORNIZA E  
POLITIKËS SË INFRAKOSIT PËR RISISTEMIM**

**MBI PËRVETËSIMIN E TOKËS PËR  
REHABILITIMIN E LINJËS HEKURUDHORE 10**

**Fushë Kosovë 2015**

## **LISTA E SHKURTESAVE**

ASH	- Autoriteti i Shpronësimit
EUR	- Euro
INF	- Institucionet Financiare Ndërkombëtare
BEI	- Banka Evropiane për Investim
IFC PS-5	- Standardi i Performancës 5 (Përvetësimi i Tokës dhe Risistemimi i Pavullnetshëm)
AKK	- Agjencia Kadastrale e Kosovës
INFRAKOS	- Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A
AKP	- Agjencia e Pronës së Kosovës
PATH	- Projekti i Asistencës Teknike për Hekurudhë
M&E	- Monitorimi dhe Vlerësimi
MI	- Ministria e Infrastrukturës
MZHE	- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MMPH	- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPMS	- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
PVR	- Plan Veprimi i Risistemimit
PKR	- Korniza e Politikës së Risistemimit
WB OP 4.12	- Politika Operacionale e Bankës Botërore 4.12 (Risistemimi i Pavullnetshëm)

## PËRMBAJTJA

<b>Sfondi i projektit</b>	.....	4
<b>Qëllimi i kornizës së politikës për risistemim</b>	.....	4
<b>Fushëveprimi i PVR-së</b>	.....	5
Parimet dhe objektivat	.....	5
Humbja e tokës	.....	6
Humbja e strehimit	.....	6
Humbja e bizneseve	.....	6
Humbja e punësimit	.....	6
Humbja e shërbimeve dhe trashëgimisë kulturore	.....	6
<b>Përgjegjësitë Institucionale</b>	.....	6
Përgatitja e planeve të veprimit të risistemimit (PVR)	.....	6
Miratimi i PVR-ve	.....	7
Vlerësimi	.....	7
Pronarët e zhvendosur gjatë luftës	.....	7
Implementimi dhe monitorimi i planit të veprimit të risistemimit	.....	7
Komisioni i pavarur për shqyrtimin e ankesave të pretenduara	.....	7
<b>Kërkesat e legjislacionit kombëtar</b>	.....	8
<b>Kërkesat nga BEI</b>	.....	8
<b>Boshllëku në mes të ligjeve kombëtare dhe ligjeve të bashkë-financierëve</b>	.....	9
<b>Pranueshmëria dhe të drejtat</b>	.....	9
Pranueshmëria dhe afati i fundit	.....	9
<b>Politika e pranueshmërisë dhe të drejtat</b>	.....	9
Matrica e të drejtave	.....	10
<b>Opsionet e risistemimit në projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore</b>	.....	14
Njësia familjare	.....	14
Pronarët e tokës	.....	14
Ngastrat alternative	.....	16
Kompensimi	.....	16
Fermerët qiramarrës që punojnë tokën dhe të tjerët që punojnë tokën (ndarësit e të mbjellave, njerëzit me të drejtat e shfrytëzimit)	.....	16
<b>Personat e prekur nga projekti</b>	.....	16

<b>Njerëzit e prekur nga humbja e strehimit</b>	.....	17
Pronarët	.....	17
Qiramarrësit	.....	18
<b>Njerëzit e prekur nga humbja e bizneseve apo godinave tregtare</b>	.....	18
<b>Njerëzit e prekur nga humbja e punësimit</b>	.....	18
<b>Shpenzimet tranzicionale</b>	.....	19
<b>Njerëzit e pambrojtur</b>	.....	19
<b>Përdorimi i zonave të mbetura në zbatimin e projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore</b>	.....	19
<b>Vlerësimi i tokës dhe asetëve</b>	.....	20
<b>Procedurat e veçanta për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore</b>	.....	20
<b>Hapja, konsultimet publike dhe pjesëmarrja</b>	.....	21
<b>Krijimi i komisionit të ankesave për dëmshpërblim</b>	.....	21
<b>Monitorimi</b>	.....	22
<b>Orari dhe buxheti</b>	.....	22
Orari dhe buxheti i integruar	.....	22
Orari dhe buxheti i llogaritur	.....	22
<b>Shtojca A: Skica e planit të veprimit të risistemimit</b>	.....	23

## **Sfondi i Projektit**

Projekti për rehabilitimin e linjës së 10 hekurudhore (Projekti) i përket rehabilitimit të një linje hekurudhore një binarëshe 149 km e gjatë e pa elektrifikuar në Kosovën qendrore. Rehabilitimi do të lejojë operimin deri në 100 km/h në shumicën e segmenteve të linjës me një ngarkesë boshtore të linjës prej 22.5 ton dhe me standardet Evropiane. Linja e 10 hekurudhore shtrihet në rrjetin hekurudhor gjithëpërfshirës të zgjeruar TENT të Observatorit Evropian të Transportit për Evropën Jug-Lindore (SEETO). Linja hekurudhore 10 është afër 250 km e gjatë dhe lidh Krlevën në Serbi, Fushë Kosovë në Kosovë dhe Shkupin në IRJM. Projekti do të implementohet në tri faza: 2015-2017, pastaj 2016-2018 dhe faza përfundimtare prej 2017-2019.

Në vitin 2009, me përkrahje financiare prej Zyrës Ndërlidhëse të KE-së (ZNKE) në Kosovë, është zhvilluar dhe miratuar nga Qeveria e Kosovës një Strategji Multimodale e Transportit, dhe në vitin 2011 kjo strategji është rishikuar dhe mbulon periudhën kohore 2012-2021. Në të njëjtin vit ZNKE-ja po ashtu ka financuar përgatitjen e një plani të veprimit dhe planit të investimeve të transportit hekurudhor. Të dyja këto dokumente ndër të tjera si prioritet kryesor e bëjnë identifikimin e investimit në linjën e Projektit si një pjesë integrale e rrjetit Pan Evropian. Në vitin 2010 Institucioni i Komisionit Evropian për Lehtësimin e Projekteve të Infrastrukturës (IPF – TA) ka financuar një studim fizibiliteti për ripërtëritjen e linjës hekurudhore në tërësi. Studimi ka konstatuar si opsion të preferuar rehabilitimin dhe përmirësimin e kufizuar të kësaj linje për të arritur shpejtësinë 120 km/h në terrenin e rrafshët, 70 km/h në terren kodrinor dhe me ngarkesë boshtore prej 22.5 tonëve në tërë gjatësinë e linjës. Në fillim të vitit 2014, autoritetet e Kosovës me sukses kanë aplikuar për një grant të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) për të financuar dizajnet e detajuara dhe vlerësimin në ndikimin ambiental për segmentin në jug të Fushë Kosovës. Këto dhe më shumë studime tjera të detajuara do të fillojnë së shpejti, ndërsa implementimi mund të fillojë më vonë në vitin 2016.

Qeveria e Kosovës ka për qëllim që të rehabilitojë të gjithë Linjën Hekurudhore 10 në territorin e vetë. Projekti do të implementohet në faza, pjesërisht për shkak të kapacitetit financiar dhe implementues të huamarrësit dhe promotorit (INFRAKOS-it) dhe pjesërisht pasi shfrytëzimi i një segmenti të linjës së 10 hekurudhore është aktualisht i kufizuar për shkak të rrethanave politike. Punët e rehabilitimit në këtë segment të fundit priten të fillojnë prej vitit 2017 e tutje. Projekti pritet të bashkë-financohet me një hua nga BERZH-i.

## **Qëllimi i kornizës së politikës për risistemim**

Kjo Kornizë e Politikës së Risistemimit (KPR) për zonën e linjës hekurudhore Leshak (kufiri me Serbinë) - Fushë Kosovë - Hani i Elezit (Kufiri me Maqedoninë), themelon politikën e Qeverisë së Kosovës sa i përket risistemimit të popullsisë që do të zhvendoset për shkak të zhvillimit të rrjetit hekurudhor (rehabilitimi i përgjithshëm i linjës hekurudhore 10) nëse do të kërkohet përvetësimi apo shpronësimi i pronës së patundshme. Në veçanti, Kjo KPR ka për qëllim të aplikohet në të gjitha aspektet e projekteve të zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore, duke përfshirë çdo risistemim

të kërkuar për shkak të përvetësimit të tokës për rehabilitimin e binarëve dhe objekteve përcjellëse.

Detajet specifike të kësaj KPR-je të cilat do të aplikohen në projektin e linjës hekurudhore 10 janë diskutuar në tërësi. Kompania e cila e udhëheq projektin mbi rehabilitimin e linjës hekurudhore 10 do të ketë të drejtë të kërkojë miratimin e risistemimit nga autoriteti shpronësues i qeverisë, e kjo do të paraqes nevojën për zhvillimin e planit të veprimit të risistemimit (PVR) nën këtë KPR. Kjo KPR është menduar të udhëheq zhvillimin e PVR-së fillestare për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10 si dhe PVR-të e së ardhmes të zhvilluara në lidhje me këtë dhe projektet tjera.

Duke ditur se punët janë planifikuar që të kryhen përbrenda të drejtës së rrugës ekzistuese, nuk pritet ndonjë risistemim i pavullnetshëm. Sidoqoftë, meqë pjesë të caktuara të projektit nuk janë në operim dhe meqë dizajni final mund të detyrojë risistemime të kufizuara të pavullnetshme, është përgatitur korniza vijuese.

Çështjet kryesore të adresuara me këtë dokument përfshijnë:

- Përcaktimin e palëve përgjegjëse për zhvillimin dhe miratimin e PVR-ve definitive për projektet që e bëjnë të nevojshme risistemimin e popullsisë. PVR-ja e parë për një projekt do të përfshijë të gjitha përcaktimet, kriteret e pranueshmërinë, përfitimet dhe procedurat për tu aplikuar gjatë një projekti. Nëse një projekt përfshinë përvetësimet e shumta me kalimin e kohës, mund të jetë e përshtatshme për të përgatitur një PVR veçmas për secilën fazë të përvetësimit. Për shembull, së pari do të definohet faza e parë prej Fushë Kosovës në Han të Elezit, së dyti prej Fushë Kosovës në Mitrovicë, dhe së treti prej Mitrovicës në Leshak, Sidoqoftë, kriteret, përfitimet dhe procedurat duhet të jenë të njëjta në secilin PVR.
- Përcaktimi i përgjegjësive institucionale për financimin dhe implementimin e një PVR-JE.

## **Fushëveprimi i PVR-së**

### **Parimet dhe objektivat**

Siç është theksuar në këtë KPR, objektivi parimor i Qeverisë është që të minimizojë përvetësimin e tokës dhe zhvendosjen në zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme dhe aktiviteteve. Objektivat e tilla janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, më specifikiht me standardet sociale të BEI<sup>1</sup>, politikën operacionale të Bankës Botërore dhe institucionet financiare ndërkombëtare (IFN-të). Aty ku zhvendosjet apo humbja e aseteve ekonomike dhe mjeteve të jetesës janë të pashmangshme, objektivi i kësaj politike është të sigurohet se njerëzit e prekur mund të përmirësohen në fund të fundit të rikthejnë standardin e tyre të jetës dhe mjeteve të jetesës në një kohë sa më të shkurtë të mundshme. Kjo KPR njeh ndikimet domethënëse sociale dhe ekonomike të përvetësimit të tokës dhe risistemimit. Ndikimet parimore sociale dhe ekonomike të përvetësimit të tokës përfshijnë:

---

<sup>1</sup> [http://www.eib.org/attachments/strategies/environmental\\_and\\_social\\_practices\\_handbook\\_en.pdf](http://www.eib.org/attachments/strategies/environmental_and_social_practices_handbook_en.pdf)

**Humbja e tokës** – Ku të gjitha apo një pjesë domethënëse e tokës bujqësore të një personi është humbur, ata do të humbin të hyrat e tyre dhe shpesh një pjesë domethënëse të furnizimit të ushqimit të tyre (Për shembull, perime, qumësht dhe shpezë). Në procesin e lëvizjes në një vend të ri ata kanë gjasa të humbin së paku një prodhim.

**Humbja e strehimit** – Me humbjen e strukturës fizike të shtëpisë, njerëzit gjithashtu do të humbin shërbimet dhe objektet përcjellëse: furnizimin me ujë, drenazhin, qasjen rrugore dhe energjinë elektrike. Në proces të lëvizjes atyre po ashtu do tu shkaktohen shpenzime tranzicionale domethënëse, duke përfshirë transportin për vetën e tyre dhe sendet e tyre personale, tarifat ligjore, taksat, dhe kështu me radhë.

**Humbja e bizneseve** – Përveç humbjes së lokaleve fizike, bizneset e vogla mund të preken nga humbja e vendndodhjeve të biznesit dhe humbjes së klientelës, sidomos konsumatorët e tyre të rregullt. Në procesin e lëvizjes ata do të humbin biznesin dhe mund t'ju shkaktohen shpenzime domethënëse të tranzicionit, duke përfshirë transportin e pajisjeve, stoqeve etj.

**Humbja e punësimit** – Nëse një biznes i prekur mbyllet, punëtorët do të humbin vendet e tyre të punës. Njerëzit tjerë mund të humbin punësimin nëse janë të obliguar të lëvizin në një distancë të largët nga vendet e punës së tyre ekzistuese.

**Humbja e shërbimeve dhe trashëgimisë kulturore** – Kjo përfshinë humbjen e qasjes në objektet siç janë: shkollat, klinikat, xhamitë, varrezat, memorialët e luftës, dhe të tjera.

## **Përgjegjësitë Institucionale**

Kur kompanitë e projekteve janë përfshirë në zhvillimin e infrastrukturës madhore dhe aktiviteteve që kërkojnë përvetësimin dhe risistemimin, përgjegjësitë e Autoritetit të Shpronësimit, Qeverisë dhe komunave duhet të jenë të qarta. Për të siguruar se personat e zhvendosur mund të përmirësojnë apo rikthejnë standardin e tyre të jetesës, ndarja e përgjegjësisë për përvetësimin e tokës dhe risistemimin në mes të INFRAKOS-it, Qeverisë, komunave dhe të tjerëve do të jetë siç vijon:

**Përgatitja e planeve të veprimit të risistemimit (PVR-ve)** – INFRAKOS do të jetë përgjegjës për përgatitjen e PVR-ve. PVR-të e tilla do të bazohen në ligjet ekzistuese, praktikat më të mira të BE-së, këtë KPR dhe çdo studim tjetër apo propozimet që janë dhënë për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10. Një PVR i detajuar do të përgatitet për secilin projekt që shkaktonte shpronësim të tokës, zhvendosje fizike të popullsisë, apo humbje të hyrave për shkak të ndryshimeve në shfrytëzim të tokës apo qasje në resurse. Secili PVR do t'i nënshtrohet konsultimit publik. Secili PVR do të jetë në pajtueshmëri me standardet e pranuar ndërkombtarisht siç janë OP 4.12 të Bankës Botërore, Standardi 6 mbi risistemimin e pavullnetshëm i BEI-së dhe IFC/Equator Group PS-5. Planet e risistemimit duhet të bazohen në informacionin e besueshëm të përditësuar dhe do të përfshijë informacionin bazë për projektet përkatëse dhe analizat e opsioneve alternative për projektet e propozuara si dhe çdo çështje ligjore që ndërlidhet me risistemimin apo çdo boshllëk në mes të ligjeve të Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare.

Përfundimisht, secili PVR do të përfshijë buxhetin dhe orarin e detajuar. Një skicë e përgjithshme për PVR-në e tillë është paraqitur në Shtojcën A.

**Miratimi i PVR-së** – Autoriteti i shpronësimit (autoriteti brenda Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor) do të jetë përgjegjës për miratimin e PVR-së dhe duhet të pranojë komentet nga palët e përfshira dhe komunat e prekura. Marrëveshjet e arritura me familjet e prekura për vlerësim dhe kompensim të aseteve mund të marrin formën e kontratës civile apo marrëveshjes formale në mes të Autoritetit të Shpronësimit dhe përfaqësuesve të familjeve të prekura.

**Vlerësimi** – Autoriteti i shpronësimit do të jetë përgjegjëse për vlerësimin e aseteve dhe të caktojë shumën e kompensimit, të sigurohet se vlerësimi është bazuar në çmimin e tregut dhe në vlerën e zëvendësimit.

**Pronarët e zhvendosur gjatë luftës** – Agjencioni Kosovar i Pronës (AKP) është përgjegjës për identifikimin dhe kontaktimin e çdo pronari të pronës. Mandati i AKP-së është i kufizuar në funksionin e tanishëm në përcaktimin e pronësisë së aseteve. Autoriteti i Shpronësimit do të jetë përgjegjës për negociim me pronarët e pronave të prekura. Opsionet e ofruara për pronarët e pronave të prekura të cilët janë zhvendosur si rezultat i luftës do të jenë saktësisht të njëjta si ato të ofruara ndaj pronarëve tjerë të prekur.

**Implementimi dhe monitorimi i planit të veprimit të risistemimit** – Autoriteti i Shpronësimit do të jetë përgjegjës për kompensim në të holla, sigurim të opsioneve tokë-për-tokë, zhvillim të pozitive të reja të risistemimit, pronë të patundshme që ka vlerë që është baras me borxhin e kompensimit; apo një kombinim të parave dhe të pronës së patundshme, të cilat së bashku kanë një vlerë të barabartë me borxhin e kompensimit dhe/ose për pagesë të kompensimit për familjet e prekura.

**Komisioni i pavarur për shqyrtimin e ankesave të pretenduara** – Një komision i pavarur i ankimit do të themelohet për të mbuluar të gjitha aspektet e projektit. Ky komision do të përbëhet nga përfaqësuesit e INFRAKOS-it, Autoritetit Shpronësues, Komunës, Komunitetit dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Nëse pronari apo mbajtësi i interesit i pronës së patundshme i cili i është nënshtruar risistemimit beson në mënyrë të arsyeshme se të drejtat e tij janë shkelur, atëherë personi i tillë mund të parashtrojë ankesë përpara këtij komisioni.

Mënyra e funksionimit të këtij komisioni të pavarur të ankimit për shqyrtim të pretendimeve do të përcaktohet në secilin PVR. Vendimi i komisionit të pavarur të shqyrtimit të ankesave të pretenduara do të jetë përfundimtar dhe nëse rasti mund të jetë që pala nuk është e kënaqur me vendim të tillë, vlerësimi i pronës së tillë nuk do t'i nënshtrohet risistemimit sipas kësaj kornize dhe procedurës së termeve ligjore të parapara me ligjin mbi shpronësimin e pronës së patundshme.

Autoriteti i Shpronësimit do të përfshijë procedurën e komisionit të pavarur për shqyrtimin e ankesave të pretenduara në mënyrë detajuese në PVR. Kjo procedurë e komisionit do të mbulojë të gjitha aspektet e projektit, në vend se thjeshtë vetëm të programit të risistemimit. Komisioni për shqyrtim të pretendimeve me përbërjen e tij siç është përshkruar më lart përkrahet nga një ekspert teknik i cili do të ketë qasje direkte në nivelet më të larta të menaxhmentit të Autoritetit të Shpronësimit,



qeverisjes lokale dhe qeverisjes qendrore. Ky komision do të financohet nga Autoriteti i Shpronësimit, por do t'i raportojë direkt Kabinetit të Ministrit për Ambient dhe Planifikim Hapësinor dhe Agjencive Financiare Ndërkombëtare të përfshira në financimin e projektit. Eksperti teknik do të ketë një zyrë në zonën e projektit dhe do të ketë transport kështu që ai/ajo të mund të vizitojë dhe të hetojë kudo në zonën e projektit. Telefoni, e-maili dhe vendndodhja e zyrës së ekspertit do të publikohet plotësisht. Të gjitha ankesat apo shqetësimet do të regjistrohen në një databazë konfidenciale. Komisionit do t'i kërkohet të hetojë dhe të përgjigjet ndaj çdo ankese apo shqetësimi brenda një periudhe prej jo më shumë se 30 ditë. Eksperti teknik po ashtu do të përgatis raportet tremujore, duke treguar numrin e ankesave, dhe duke identifikuar çështjet e ngritura dhe masat që janë ndërmarrë për të zgjidhur problemet të cilat janë paraqitur. Informatat e emrave dhe kontakteve të ankuesve (adresat, numri i telefonit, e-maili etj.) do të mbesin konfidenciale, ato do të regjistrohen në databazë, por nuk duhet të zbulohen në raportet tremujore.

### **Kërkesat e legjislacionit kombëtar**

Korniza e Politikës së Risistemimit do të jetë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin ekzistues në Kosovë me të cilin rregullohet ky segment. Kjo KPR do të jetë në pajtueshmëri me ligjet e Kosovës në vijim:

1. Ligji për Shpronësimin e Pronës së Patundshme - Nr. 03 / L-139.
2. Ligji për Alokimin e shfrytëzimit dhe Shkëmbimit të Pronës së Patundshme të Komunës - Nr. 03 / L- 226
3. Ligji për Alokimin e shfrytëzimit dhe Shkëmbimit të Pronës së Patundshme të Komunës - Nr. 04 / L - 144
4. Ligji mbi ndryshimin e Ligjit Nr. 03 / L-139 për Shpronësimin e Pronës së Patundshme Nr. 03 / L- 205
5. Ligji për Rregullimin e Tokës Nr. 04 / L – 040
6. Ligji për Pronën dhe të Drejtat Tjera Reale Nr. 03 / L - 154

### **Kërkesat nga BEI**

Kërkesat e BEI-së lidhur me risistemimin e pavullnetshëm, kompensimin, datën e ndërprerjes dhe përvetësimin e tokës janë definuar dhe përcaktuar në Standardin 6 mbi risistemimin e pavullnetshëm në Manualin Hapësinor dhe Social të BEI-së. Sipas këtij standardi, risistemimi konsiderohet i pavullnetshëm kur njerëzit apo komunitetet e prekura nuk kanë të drejtë për të refuzuar përvetësimin e tokës që rezulton në zhvendosje. Risistemimi i pavullnetshëm ndërlidhet me humbjen e banimit, strehimit, të hyrave, tokës, mjeteve të jetesës, asetëve, si dhe në mes të tjerash qasjeve në burime dhe shërbime. Standardi i BEI-së po ashtu parasheh një obligim për të përcaktuar datën e ndërprerjes për të bërë një studim bazë, regjistrim dhe të implementohet një sondazh socio-ekonomik. Sa i përket kompensimit, standardi i BEI-së parasheh obligim për promoterin për të paguar kompensim të drejtë bazuar në koston e zëvendësimit të plotë në kohë të mirë për asetet e shpronësuara të personave të prekur. Standardet e BEI-së kërkojnë që promoteri të ua ofrojë personave të prekur një informatë mbi mundësinë e zgjedhjes, qoftë të kompensimit të llojit (tokë-për-tokë) apo të kompensimit monetar në fillim.

## **Boshllëku në mes të ligjeve kombëtare dhe politikave të bashkë-financierëve**

Në rast të ndonjë boshllëku në mes të ligjeve kombëtare dhe standardeve relevante të BEI-së, që nuk janë identifikuar ndryshe në kohën e miratimit të kësaj politike. Autoriteti i Shpronësimit do të bënë plotësimin e kësaj diference si pjesë të përgatitjes së një PVR-je. Një plotësim i tillë do të sigurojë pajtueshmëri me standardet e BEI-së.

## **Pranueshmëria dhe të drejtat**

### **Pranueshmëria dhe afati i fundit**

E drejta për të pranuar kompensimin dhe asistencën e risistemimit do të përkufizohet nga afati i fundit i cili paraqet ditën kur vrojtimet në terren do të drejtohen nga konsulentët ndërkombëtarë të rekrutuar për zbatimin e projekt dizajnit të detajuar të secilës fazë të Projektit. Data e regjistrimit definitiv dhe vrojtimet të aseteve të popullatës të kryera për përgatitjen e PVR-ve do të përdoret si afati i fundit për pranueshmërinë e përfitimeve të risistemimit. Afati i fundit do të zbulohet dhe shpërndahet publikisht në media dhe në takimet këshilluese në komunitetet përkatëse të prekura para se të kryhet vrojtimet/regjistrimit.

Vrojtimi do të bënë identifikimin dhe vendosjen e familjeve të cilat jetojnë në zonën e Projektit, duke përfshirë çdo ardhës zaptues/informal të cilët mund të jetojnë në tokë publike dhe do të preken nga Projekti. Po ashtu do të krijojë një regjistrim të të gjitha humbjeve në nivelin familjar, duke përfshirë ndërtimet, pemët dhe ndërtimet shoqërore. Çdo person që lëviz në zonën e Projektit pas afateve të fundit nuk do të ketë të drejtën për kompensim apo ndonjë asistencë prej INFRAKOS-it.

Një procedure rishikimi do të vendoset për të përcaktuar gjendjen e çdo njeriu që pretendon se është shmangur nga regjistrimi. Informatat e regjistrimit do të ndahen me Qeverinë dhe autoritetet e komunave lokale dhe ata së bashku do të jenë përgjegjës për të siguruar që zona e prekur nuk do të pushtohet nga zaptuesit që kërkojnë përfitime të risistemimit.

## **Politika e pranueshmërisë dhe të drejtat**

Të gjithë personat e afektuar nga projekti do të kenë të drejtën për kompensim dhe asistencë të risistemimit bazuar në peshën e ndikimeve. Megjithatë, pranueshmëria për të pranuar kompensim dhe asistencë tjera do të kufizohet nga afati i fundit.. Mungesa e titullit ligjor nuk do të pengojë personat e afektuar nga projekti për kompensim dhe asistencë, ashtu siç është specifikuar në matricën e pranueshmërisë

Matrica e pranueshmërisë e shfaqur në "Tabelën 1" përmbledh opsionet e risistemimit që do të ofrohen për kategoritë e ndryshme të personave të prekur nga projekti. Opsionet e risistemimit në kontekst të projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore 10 janë përshkruar më detajisht në vijim në Tabelën 1.

**Tabela 1: Matrica e të drejtave**

<b>Njerëzit e Prekur</b>	<b>Opsionet</b>	<b>Vrojtimet</b>
<b>Njerëzit e prekur me humbje të tokës bujqësore</b>		
<p>Pronarët me titull të plotë ligjor ngastrat e të cilëve do të jenë plotësisht të prekura (njerëzit, shtëpitë e të cilëve janë të prekura po ashtu kanë të drejtë në opsionet e përshkruara më poshtë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një ngastër alternative mbi tokën e rehabilituar + kompensim për asetet tjera (hangarët, anekset, të mbjellat permanente, etj), apo</li> <li>• Kompensim në para për tokën dhe asetet tjera plus të gjitha shpenzimet tranzicionale (transporti, tarifatat ligjore, humbjen e të mbjellave apo të ardhurave)</li> </ul>	<p>Në rast të parave, kompensimi duhet të jetë i mjaftueshëm për t'i mundësuar përfituesit që të marrë një ngastër më të mirë apo së paku baras me ngastrën e prekur.</p>
<p>Pronarët e njohur që nuk kanë titull të plotë ligjor për tokën dhe ngastrat e të cilëve do të jenë plotësisht të prekura po ashtu kanë të drejtë në opsionet e përshkruara më poshtë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një ngastër alternative mbi tokën e rehabilituar plus kompensim për asetet tjera (hangarët, anekset, të mbjellat permanente, etj), apo</li> <li>• Kompensim në para për tokën dhe asetet tjera plus të gjitha shpenzimet tranzicionale (transporti, tarifatat ligjore, humbjen e të mbjellave dhe/apo të ardhurave)</li> </ul>	<p>Në mungesë të titullit të plotë ligjor pronari/ët duhet të njihen si person/a me të drejta të plota, të pakundërshtueshme mbi pronën. Kjo do të kërkonte rregullimin e të drejtave të pronësisë apo një dëshmi me betim nga fqinjët, e vërtetuar nga komuna</p>
<p>Pronarët të cilët kanë ikur nga zona si rezultat i luftës në Kosovë, dhe pronat e të cilëve janë plotësisht të prekura</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një ngastër alternative mbi tokën e rehabilituar plus kompensim për asetet tjera (hangarët, anekset, të mbjellat permanente, etj), apo</li> <li>• Kompensim në para për tokën dhe asetet tjera plus të gjitha shpenzimet</li> </ul>	<p>AKP-ja do të jetë përgjegjëse për përcaktimin e pronësisë së aseteve.</p>

	tranzicionale (transporti, tarifate ligjore, humbjen e të mbjellave apo të ardhurave)	
Pronarët pronat e të cilëve janë të prekura pjesërisht (dmth ku zonat e mbetura janë të realizueshme)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kompensimi për humbjen e tokës bujqësore dhe asetëve tjera në zonat e prekura (hangarët, anekset, të mbjellat, etj.)</li> </ul>	Ligji në fuqi përcakton rastet e shpronësimit të pjesërishtëm. Neni 13 i Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme - Nr. 03 / L-139 .
Bujqit qiramarrës apo ata që kanë marrë pronën përgjysmë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kompensimi për humbjen e të ardhurave neto për dy vite plus të gjitha shpenzimet tranzicionale (transporti dhe tarifate ligjore)</li> </ul>	Të sigurohet që qiramarrësit e prekur të mund të kompensojnë humbjet
Jo-pronarët të cilët kanë zaptuar pronën private, pa pëlqimin e pronarit dhe që do të merret, e cila iu takon njerëzve të cilët kanë ikur gjatë luftës së fundit në Kosovë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kompensim në para për vlerën e përmirësimeve të bëra dhe të mbjellave që janë në këmbë.</li> </ul>	
<b>Njerëzit e prekur nga humbja e shtëpive të tyre dhe tokës së banimit</b>		
Pronarët e njohur me apo pa titull formal për shtëpitë e tyre (përveç kompensimit të humbjes së tokës bujqësore)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Një shtëpi të re dhe një ngastër banimi në një fshat të risistemuar, ose</li> <li>Kompensim në kosto të zëvendësimit plus të gjitha shpenzimet tranzicionale (tarifate ligjore, taksat, transport të sendeve personale, etj.)</li> </ul>	Zëvendësimi i strehimit do të plotësoj standardet bazë për strehim social siç janë përcaktuar në standardin e BEI-së mbi risistemimin e pavullnetshëm dhe shërbime dhe do të sigurohet pa marrë parasysh kushtet apo vlerën e pronës së prekur, nëse objektet ilegale janë ndërtuar në pronë private nga pronari i vet, dhe: <p>a) Në datën kur ka filluar aktiviteti ndërtues ekzistues, ka qenë e pamundur për pronarin që të marrë lejen e nevojshme të ndërtimit</p>

		<p>nga autoriteti përkatës komunal sepse në datën e tillë nuk është lëshuar ende ndonjë plan urban apo hapësinor që mbulon pronën e tillë, dhe</p> <p>b) As objekti e as ndërtimi nuk ka paraqitur shkelje të ndonjë ligji apo rregulloreje të aplikueshme në atë kohë.</p> <p>Në mungesë të titullit të plotë ligjor pronari/ët duhet të njihen si person/a me të drejta të plota, të pakundërshtueshme mbi pronën. Kjo do të kërkonte rregullimin e të drejtave të pronësisë apo një dëshmi me betim nga fqinjët dhe e vërtetuar nga komuna.</p>
<p>Pronarët e shtëpive që kanë ikur nga zona si rezultat i luftës së fundit në Kosovë</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një shtëpi të re dhe një ngastër banimi në një fshat të risistemuar, ose</li> <li>• Kompensim në kosto të zëvendësimit plus të gjitha shpenzimet tranzicionale (tarifat ligjore, taksat, transport, etj.)</li> </ul>	<p>AKP-ja do të jetë përgjegjëse për vërtetimin e pronësisë.</p>
<p>Qiramarrësit me marrëveshje formale të qiramarrjes</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kompensim i barasvlershëm me gjashtë muaj qira plus të gjitha shpenzimet tranzicionale (tarifat ligjore dhe taksat, transporti, etj.)</li> </ul>	<p>Qiramarrësi do të kompensohet për dëmin si pasojë e ndërprerjes së kontratës. Nevojitet të përcaktohet nëse marrëveshje të reja të qiramarrjes mund të rregullohen. Përfituesi duhet të ketë një marrëveshje formale prej para afatit të fundit për pranueshmëri.</p>

Jo-pronarët zaptues të banimeve, duke përfshirë zaptuesit e shtëpive të braktisura nga njerëzit gjatë luftës (Zaptuesit)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndhimë tranzicionale për të larguar plaçkat</li> <li>• Kompensimi i qirasë mujore për hapësirë të barasvlershme diku tjetër.</li> </ul>	
<b>Njerëzit e prekur nga humbja e bizneseve dhe ndërmarrjeve tjera</b>		
Pronarët e lokaleve të bizneseve siç janë shitoret, punëtoritë apo garazhet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zëvendësimi i lokaleve në një fshat të risistemuar, ose</li> <li>• Kompensim për humbje të lokaleve plus kompensim për humbje të të hyrave neto për 6 muaj ose të hyrave neto për 12 muaj nëse përfituesi rivendos një biznes në komunë plus të gjitha shpenzimet tranzicionale, duke përfshirë paketimin dhe transportin e pajisjeve, tarifave ligjore, taksave, etj.</li> </ul>	Normat e ndryshme të kompensimit janë ofruar për të inkurajuar dhe/ose lehtësuar pronarin që të rivendos biznesin apo të vendos një biznes të ri në komunën e prekur.
Jo-pronarët / Punëtorët	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kompensim për humbje të të hyrave neto për 6 muaj ose të hyra neto për 12 muaj nëse përfituesi rivendos një biznes në komunë plus të gjitha shpenzimet tranzicionale, duke përfshirë paketimin dhe transportin e pajisjeve, tarifave ligjore, taksave, etj.</li> </ul>	Normat e ndryshme të kompensimit janë ofruar për të inkurajuar pronarin që të rivendos biznesin apo të vendosë një biznes të ri në komunën e prekur.
Qeveria, komunat dhe kompanitë e shërbimeve publike (për asetet siç janë ndërtesat shkollore, klinikat, furnizimi me ujë, linjat e furnizimit me energji, etj.)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kompensimi i aseteve në koston e zëvendësimit, ose</li> <li>• Zëvendësimi i aseteve në vendet e reja të risistemit</li> </ul>	Të dakordohet në bazë të rast pas rasti.
Asetet e komunitetit, në	• Zhvendosja dhe	Të dakordohet me

veçanti xhamitë, varrezat & kishat	restaurimi, ose zëvendësimi	komunitetet në bazë të rast pas rasti.
<b>Njerëzit e prekur nga humbja e punësimit</b>		
Punëtorët me kohë të plotë pune që humbin punësimin për shkak të shpronësimit të godinave të punëdhënësit të tyre	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kompensim i barasvlershëm më pagën e gjashtë muajve</li> <li>Ndihmë financiare (Euro 1,000) për të mbuluar shpenzimet e trajnimeve të shkathësive apo kërkesës për punë.</li> </ul>	<p>Kompensimi do të bazohet në të ardhurat e tyre mesatare përgjatë 12 muajve të fundit.</p> <p>Ndihma do të jepet për të gjetur punësim alternativ.</p>
Njerëzit që humbin punësimin me kohë të rregullt të pjesërishme të punës	Kompensim i barasvlershëm me të ardhura të pjesërishme për gjashtë muaj plus përkrahje për të gjetur punë apo mundësi për trajnim.	<p>Kompensimi do të bazohet në të ardhurat e tyre mesatare përgjatë 12 muajve të fundit.</p> <p>Ndihma do të jepet nga Autoriteti i Shpronësimit për të gjetur punësim alternativ.</p>

### **Opsionet e risistemimit në projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore**

Në kontekst të projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore, opsionet e risistemimit në vijim do të ofrohen për kategoritë e ndryshme të personave të prekur nga ai projekt: Njerëzit e prekur me humbje të tokës (tokë bujqësore, kulloso, pyje).

**Njësia familjare** - Termi “njësi familjare” konsiderohet çdo familje apo komunitet tjetër i personave, të cilët deklarojnë se jetojnë së bashku dhe bashkërisht ndajnë të ardhurat e tyre për të plotësuar nevojat bazë jetësore.

**Pronarët e tokës** – Njerëzve toka e të cilëve është prekur nga projektet e rehabilitimit të linjës hekurudhore, do tu ofrohet ose një ngastër alternative në një zonë të tokës që aktualisht i takon Qeverisë (tokë për tokë), ose kompensim në para mjaftueshëm për të siguruar një ngastër tjetër toke të zonës dhe kualitetit të barasvlershëm me ngastrën e prekur. Të gjitha shpenzimet tranzicionale do të përballohen drejtpërdrejt ose të kompensohen nga Qeveria. Këto shpenzime do të përfshijnë shpenzimet e transportit të pajisjeve, makinerisë, bagëtisë, dhe të gjitha asetëve tjera të tundshme, të gjitha tarifatat ligjore dhe taksat e nevojshme për transfer të tokës së tyre dhe sigurimin e ngastrave të zëvendësimit, dhe kompensimin për çdo humbje të të mbjellave apo çdo humbje tjetër të të hyrave dhe/ose mjeteve të jetesës.

Dy opsionet do tu ofrohen të gjithë pronarëve të tokës ngastrat e të cilëve plotësisht janë prekur, të cilët varen nga prona e prekur për një pjesë domethënëse të jetesës apo mjeteve të tyre të jetesës, dhe të cilët nuk zotërojnë apo zптоjnë prona tjera të realizueshme. Pronarët e tokës që nuk varen nga toka e tyre d.m.th toka e të cilëve është pjesërisht e prekur, të cilët japin me qira tokën e tyre nën qiramarrje formale ose marrëveshje të ndarjes së të mbjellave ose të cilët kanë prona tjera të realizueshme, do të kenë të drejtën vetëm për kompensim. Kriteret për përcaktimin se cilat prona janë klasifikuar si plotësisht të prekura dhe cilat janë klasifikuar si pjesërisht të prekura, janë vendosur më poshtë në "Kriteret e Pranueshmërisë". Këto opsione do të ofrohen pa marrë parasysh nëse pronarët e tokave banojnë apo jo në ngastrat e prekura (të drejtat për njerëzit shtëpitë e të cilëve janë prekur, janë të vendosura ndaras më poshtë). Opsionet do tu ofrohen të gjithë atyre njerëzve që kanë titull ligjor për tokën ose të cilët njihen të kenë të drejta të plota, të pakundërshtueshme të pronësisë. Në lidhje me të drejtat e parregullta duhet të theksohen pikat në vijim:

- Toka e cila fillimisht është marrë përmes një transferi të parregullt (siç është kontrata civile e paregjistruar) do të duhet të rregullohet nga gjyqet dhe pastaj të regjistrohet në zyrën e duhur kadastrale të komunës, e cila nga ana e saj do të informojë Agjencionin Kadastral të Kosovës (AKK). Kostoja e rregullimit të titullit do të mbulohet nga Autoriteti i Shpronësimit.
- Personat tjerë që kërkojnë pronësinë, por iu mungojnë titujt e plotë ligjor, do t'ju duhet të shfaqin se ata kanë jetuar dhe punuar në tokën e prekur për 10 vitet e fundit ose e kanë trashëguar apo ligjërisht i kanë marrë të drejtat e limituara mbi tokën. Kërkesa do të shqyrtohet nga zyra për risistemim e Autoritetit të Shpronësimit dhe duhet të mbështetet me dëshmi nga komuna (për shembull, të dhënat e taksave), institucionet qeverisëse (për shembull, të dhënat shkollore), apo dëshmitë me betim nga fqinjët.
- Nëse ka pretendime të jashtëzakonshme për pronën, duke përfshirë mosmarrëveshjet mbi pronësinë, kufijtë apo trashëgimin, autoriteti i Shpronësimit do të depozitojë vlerën e llogaritur të tokës dhe pronës në një llogari të veçantë dhe do të paguajë vetëm kompensimin apo të ofrojë përfitime tjera të risistemimit atëherë kur mosmarrëveshja është gjykuar në gjyqe. Nëse ka hipotekë në pronë, Autoriteti i Shpronësimit do të negociojë me debitorin me qëllim të transferimit të hipotekës në pronën e re të marrë nga pronari i tokës së prekur.
- AKP-ja do të jetë përgjegjëse për përcaktimin e pronësisë së tokës që është braktisur dhe/ose zaptuar nga të tjerët gjatë luftës së vitit 1999 dhe periudhave pasuese të trazirave. Atëherë kur AKP-ja ka vendosur pronësinë e tokës, pronari do të ketë të drejtë për saktësisht të njëjtat përfitime të risistemimit si çdo pronar tjetër i tokë së prekur. Jo-pronarët që zптоjnë pronën e cila i takon njerëzve që kanë ikur gjatë luftës do të kenë të drejtën në kompensim me para për përmirësimet dhe pagesën për humbje të të mbjellave që janë në këmbë, por nuk do të kenë të drejtën për ndonjë nga përfitimet tjera të risistemimit.



**Ngastrat alternative** – Kompensimi i drejtuar në blerjen e ngastrave alternative inkurajon familjet e prekura që të marrin ngastra të reja të tokës bujqësore. Shuma në dispozicion për blerje të tillë do të përcaktohet në bazë të vlerës zëvendësuese të tokës së prekur, strehimit dhe asetëve tjera të patundshme, plus 10% pagesë stimuluese me qëllimin që ky opsion të bëhet më tërheqës për pronarët e pronave të prekura. Atëherë kur është përcaktuar shumta, pronari i tokës do të jetë i lirë që të mundohet të gjejë një ngastër të përshtatshme për pak a shumë të njëjtën vlerë. Autoriteti i Shpronësimit do të shqyrtojë blerjen e propozuar, për tu siguruar se toka dhe asetet tjera janë vlerësuar korrekt dhe se dokumentet janë në rregull dhe se nuk ka ndonjë mosmarrëveshje të jashtëzakonshme mbi kufijtë, dhe do të paguajë për tokën, duke transferuar direkt titullin tek pronari i tokës së prekur.

**Kompensimi** – Kompensimi në para nuk është opsioni i preferuar për pronarët toka bujqësore e të cilëve është prekur plotësisht. Përvoja tregon se familjet e prekura shpesh përdorin kompensimin e tyre për qëllime tjera, duke i lënë ata pa mjetet për të kthyer mjetet e tyre të jetesës dhe standardet e tyre të jetesës. Kompensimi në para është opsioni i vetëm real për pronarët pronat e të cilëve janë pjesërisht të prekura. Veç kësaj ekzistojnë situata kur kompensimi mund të sigurojë një mundësi të dobishme për njësitë familjare të prekura për të ndryshuar gjendjen. Autoriteti i Shpronësimit do të punësojë një ekip të vogël të ekspertëve, të cilët do t'i shpjegojnë njësive familjare të prekura opsionet e ndryshme dhe do tu ndihmonin të vendosin se cili opsion do të ishte më i përshtatshëm. Ekspertët do të shqyrtojnë gjendjen e të gjithë pronarëve toka e të cilëve është prekur dhe të diskutojnë shfrytëzimin e kompensimit me ta para se pagesa e kompensimit të dorëzohet.

**Fermerët qiramarrës dhe të tjerët që punojnë tokën (bujqit që shfrytëzojnë tokën përgjysmë, njerëzit me të drejtat e shfrytëzimit)** – Fermerët qiramarrës do të pranojnë kompensim të barasvlershëm me dy vite të humbjes së të ardhurave neto, plus të gjitha shpenzimet e transportit dhe tarifave ligjore. Kompensimi i tillë ka për qëllim tu japë qiramarrësve dhe atyre që shfrytëzojnë tokën përgjysmë, kohë të mjaftueshme për të rregulluar një qiramarrje të re apo marrëveshje të shfrytëzimit për gjysmë të tokës dhe supozimeve që ata do të humbin së paku një vjet të korrjes dhe mund t'ju nevojitet një vit tjetër për të gjetur një pronar toke që është i gatshëm t'ju lejoj atyre që të marrin me qira apo përgjysmë një ngastër apo tokë bujqësore të barasvlershme.

## **Personat e prekur nga projekti**

Personat e prekur nga projekti janë definuar për të përfshirë kategoritë në vijim:

- Personat e prekur nga projekti, me titull formal, të cilët humbin të tërën apo një pjesë të tokës së tyre;
- Personat e prekur nga projekti, me titull formal, që kanë pronë të patundshme me apo pa leje ndërtimi në tokën që do të shpronësohet;
- Personat e prekur nga projekti me titull formal mbi bizneset që janë të prekura me humbjen e tërësishme apo të pjesërishtme të tokës në të cilën gjenden bizneset;

- Personat e prekur nga projekti me titull formal mbi blegtorinë dhe procesorë bujqësor që janë prekur nga humbja e tërësishme apo e pjesërishme e tokës në të cilën gjenden ato;
- Personat e prekur nga projekti me titull formal të qiramarrjes në tokën private apo publike;
- Personat e prekur nga projekti me titull formal mbi tokën që do të nevojitet gjatë ndërtimit në një bazë të përkohshme;
- Personat e prekur nga projekti pa titull formal në tokën apo bizneset e prekura por mjetet e tyre të jetesës janë direkt të varura në tokën apo bizneset e prekura (psh. ata që punojnë në tokën bujqësore të prekur ose që punojnë në bizneset e prekura);
- Personat e prekur nga projekti pa titull formal të pronësisë apo shfrytëzimit por të cilët kanë vendosur shfrytëzim të tokës publike apo private duke investuar në objektet e patundshme, të mbjella, pyje, pemë, pemë frytdhënëse, vreshtat, vjetërsia e të mbjellave, dhe koha e nevojitur për të riprodhuar ato; dhe
- Çdo objekt komuniteti i prekur po ashtu do të rindërtohet ose do të sigurohet përkrahje e duhur për lidhjen e tyre me komunitetin që humbin qasjen në objektet e tilla të përbashkëta.

## **Njerëzit e prekur nga humbja e strehimit**

### **Pronarët**

Njerëzit shtëpitë e të cilëve janë prekur nga marrja e tokës do tu ofrohen opsionet e një shtëpie alternative në një fshat të ri apo kompensim në para. Këto opsione do tu ofrohen të grithe fermerëve që banojnë në fermat e tyre dhe të gjithë njësitë familjare që zotërojnë apo zптоjnë shtëpitë në zonën e prekur nga projekti, pa marrë parasysh statusin ligjor të titujve të tyre. Sidoqoftë nuk do të zbatohet për qiramarrësit që kanë marrëveshje formale të qiramarrjes apo për njerëzit që kanë zaptuar shtëpitë të cilat janë braktisur nga njerëzit të cilët kanë ikur gjatë luftës.

Zëvendësimi i strehimit do të përfshijë sigurimin e strehimit bazë social që plotëson standardet nacionale dhe komunale. Madhësia e saktë e shtëpisë së zëvendësuar dhe numri i dhomave do të përcaktohet nga madhësia e njësisë familjare dhe jo nga vlera e shtëpisë që është prekur. Ky opsion ka për qëllim për ta bërë risistemimin tërheqës për familjet më të varfra, të pambrojtura, sidomos njerëzit që jetojnë në kushtet e strehimit të rëndomtë. Po ashtu ka për qëllim si një opsion që do tu lejonte fqinjëve, shokëve dhe të afërmeve të vazhdojnë të jetojnë në afërsi. Njësitë familjare që zgjedhin të pranojnë shtëpi zëvendësuese më të vogla në hapësira të ulëta se sa shtëpitë e tyre aktuale po ashtu do të pranohet kompensim në para të vlerësuar për të mbuluar diferencën në hapësirë. Nëse ata dëshirojnë, njerëzit me shtëpi më të mëdha e më të vlefshme, do të lejohen të zgjedhin për kompensim në para për shtëpitë e tyre dhe ndërtimet tjera dhe një ngastër ndërtimi në fshatin e risistemuar.

Projekti i ri i strehimit do të sigurojë shtëpi me qasje në shërbimet minimale të infrastrukturës, duke përfshirë qasjen në rrugë, drenazhim, furnizimin me ujë, kanalizimin, rrymën elektrike dhe ndriçimin rrugor.

Njerëzve të cilëve u janë dhënë shtëpi të reja në fshatin e risistemuar, do tu jepen tituj zotërimi, të lëshuar në emra të përbashkët të dy bashkëshortëve. Jo-pronarët dhe njerëzit shtëpitë e para të cilëve kanë qenë të vlefshme më pak se vlera nominale e shtëpisë së re, nuk do të lejohen të shesin apo transferojnë shtëpitë e tyre palës së tretë për një periudhë prej pesë viteve pa miratimin e menaxherit të programit të risistemimit. Kjo bëhet për të zvogëluar mundësinë e familjeve me të hyra të ulëta që të shesin shtëpitë e tyre për të nxjerrë të holla.

### **Qiramarrësit**

Qiramarrësit që kanë me qira shtëpitë apo apartamentet e tyre nën marrëveshje formale të qiramarrjes do të paguhet në barasvlerë të qirasë për gjashtë muaj plus të gjitha kostot tranzicionale siç janë transporti për sendet e tyre personale dhe çdo tarifë ligjore apo taksa, dhe do tu sigurohet ndihmesë për të gjetur strehim të përshtatshëm alternativ.

### **Njerëzit e prekur nga humbja e bizneseve apo godinave tregtare**

Qëllimi është të inkurajohen burrat dhe gratë në biznes për të vazhduar operimin gjetiu ose për të themeluar një biznes të ri. Aty ku një biznes i prekur është drejtuar në godinat që i takojnë pronarit, pronarit do t'i ofrohen opsionet e një vendi alternativ për biznes në fshatin e risistemuar ose kompensim për tokën dhe godinat e tij/saj me vlerën e zëvendësimit. Pronari po ashtu do të paguhet me barasvlerën e gjashtë muajve të humbjes së të ardhurave neto nëse ai/ajo zgjedh kompensimin dhe dymbëdhjetë muaj humbje të ardhurave neto nëse ai/ajo zgjedh për të vendosur biznesin apo të hap një biznes të ri në fshatin e risistemuar ose gjetiu në komunë. Autoriteti i Shpronësimit po ashtu do të paguajë të gjitha kostot tranzicionale, siç janë paketimi dhe transportimi i pajisjeve dhe/ose stoqeve në vendin e ri, tarifatat ligjore, taksat, dhe kështu me radhë, dhe/ose do të sigurojë ndihmesë dhe përkrahje logjistike për të vendosur një biznes të ri.

Nëse biznesi operon nga godinat e huazuara apo të marra me qira, pronari i biznesit do të paguhet për gjashtë muaj humbje të të ardhurave neto apo dymbëdhjetë muaj humbje të të ardhurave neto nëse ai/ajo vendos biznesin apo fillon një biznes të ri në vendndodhjen e risistemimit ose në ndonjë vend tjetër në komunën e njëjtë. Pronari po ashtu do të paguhet për të gjitha kostot tranzicionale, duke përfshirë paketimin dhe transportimin e pajisjeve dhe stoqeve, tarifatat ligjore, taksat, dhe kështu me radhë, dhe/ose do t'i sigurohet ndihmesë dhe përkrahje logjistike për të vendosur një biznes të ri.

### **Njerëzit e prekur nga humbja e punësimit**

Njerëzve të cilët humbin punësimin e tyre si rezultat i marrjes apo mbylljes së vendeve të tyre të punës do tu jepet barasvlera e së paku pagesës gjashtë mujore (bazuar në të ardhurat mesatare në vit para mbylljes së biznesit të punëdhënësit). Një pagesë e përnjëhershme 1,000 Euro do të jepet për të ndihmuar me shpenzimet në trajnimin e shkathtësive apo kërkim të punës për njerëzit në punësim të rregullt me kohë të plotë dhe në punësim të rregullt me kohë të pjesshme. Projekti do të

paguaj çdo pagesë tjetër të tepricës të kërkuara me ligj, duke përfshirë pagesat e përcaktuara me gjatësi të shërbimit dhe/ose faktorë tjerë.

### **Shpenzimet tranzicionale**

Shpenzimet tranzicionale janë shpenzimet e ndërlidhura me lëvizjen prej vendndodhjes origjinale në një vendndodhje tjetër si dhe humbja e të ardhurave dhe/ose përfitimet e mjeteve të jetesës. Përfshinë të gjitha tarifat ligjore, anketimet dhe tarifat e regjistrimit, të nevojshme për të transferuar pronësinë dhe marrë një pronë të re, si dhe shpenzimet e paketimit dhe transportimit për sendet personale të njësisë familjare të prekur, pajisjeve dhe bagëtisë. Po ashtu do të mbulojë çdo dëmtim në sendet personale dhe mallrat gjatë risistemimit.

Në rast të vonesës në disponueshmërinë e strehimit të risistemimit, Autoriteti i Shpronësimit do të sigurojë strehim me qira dhe mjete jetese siç kërkohet.

### **Njerëzit e pambrojtur**

Anketimi bazë socio-ekonomik për secilin PVR do të identifikojë njësitë familjare të pambrojtura, siç janë nënat e vetme, vejushat dhe vejanët, njerëzit e paftë, apo ata që jetojnë në varfëri të skajshme. Autoriteti i Shpronësimit gjatë risistemimit do t'i vlerësojë këto njësi familjare në kontekstin e rrjeteve të sigurisë formale dhe informale në dispozicion dhe të ndajë burime në PVR për t'i ndihmuar në sigurimin e strehimit dhe shërbimeve.

### **Përdorimi i zonave të mbetura në zbatimin e projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore**

Aktualisht INFRAKOS definojnë se nuk ka ndonjë pronë që do të prekej në implementimin e këtij projekti. Sidoqoftë, në praktikë nëse disa prona do klasifikoheshin si pjesërisht të prekura, një përcaktim më praktik që do të mund të adoptohej është tu ofrohet palëve të prekura opsioni i kompensimit të pronës së tyre në tërësi nëse:

- ndonjë pjesë e strukturës së shtëpisë, fermës apo biznesit është prekur;
- më shumë se 25% e totalit të pronës nevojitet që të merret;
- zona e mbetur është më pak se 0.5 e një hektari;
- prona është lënë pa qasje të zbatueshme rrugore apo humb qasjen në ndonjë aset tjetër vendimtar, siç janë furnizimi me ujë apo me energji elektrike, ose
- pronari mund të paraqes se prona e mbetur nuk është më tutje e përdorshme për shfrytëzim për të cilin është vendosur më herët. Në këtë rast pronari do të duhet të vërtetojë se zona e mbetur nuk është më tutje e përdorshme.

Në secilin nga këto raste pronari origjinal do të ketë të drejtën për të mbajtur zonën e mbetur nëse ai/ajo dëshiron.

## **Vlerësimi i tokës dhe asetëve**

### **Parimet e vlerësimit**

Toka dhe të gjitha asetet tjera të prekura do të kompensohen në pajtim me kriteret e kësaj KPR-je. Kjo do të thotë se të gjitha ndërtesat, rrethojat dhe strukturat tjera, pemët, të mbjellat e përhershme dhe anekset duke përfshirë kullosat dhe të mbjellat që janë në këmbë, do të vlerësohen me koston e nevojshme për t'i zëvendësuar, pa marrë parasysh gjendjen e tyre në kohën e vlerësimit. Vlerësimi i pemëve dhe të mbjellave të përhershme do të merr në konsideratë vlerën e prodhimeve që do të humbin. Vlera e tokës bujqësore do të vlerësohet në bazë të klasifikimit të llojeve të tokës aktualisht të aplikuara nga INFRAKOS por çmimi do të bazohet në çmimet e paguara në transaksionet aktuale të tokës në komunën e njëjtë dhe komunat fqinje. Është me rëndësi të sigurohet se vlerësimi është bazuar në transaksionet reale të tokës. Veç kësaj pronarët e tokës, pronarët e shtëpive dhe pronarët e bizneseve do të kompensohen për të gjitha shpenzimet tranzicionale.

### **Procedurat e veçanta për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore**

INFRAKOS do të jetë përgjegjës për implementimin e procedurave, që do të përcaktohen më detajisht në PVR.

Më së pakut, Autoriteti i Shpronësimit do të fillojë duke vendos kontakt me palët e prekura, Në fazat fillestare kjo do të përfshijë përcjelljen e kontakteve veçse të vendosura nga INFRAKOS-i por do të kërkojë një regjistrim të ri, përfundimtar. Secila fazë pasuese e projektit hekurudhor do të kërkojë një regjistrim të ri për tu kryer si pjesë e përgatitjes së secilit PVR. Nëse një palë e prekur pajtohet pjesërisht, Autoriteti i Shpronësimit atëherë do të kryejë një anketim të plotë të personave të prekur apo pronës së njësisë familjare dhe asetëve dhe do të vlerësojë: i) nëse prona duhet të klasifikohet si plotësisht apo pjesërisht e prekur, dhe ii) vlera e tokës dhe asetëve në zonën apo pronën e prekur, duke u bazuar në atë nëse janë klasifikuar si pjesërisht apo tërësisht të prekura.

Vlerësimi fillestar duhet të detajohet, duke pasuar procedurat e INFRAKOS-it, duke dalluar vlerën e tokës dhe vlerën e secilit aset të prekur: shtëpitë, hangarët, rrethojat, pemët dhe të mbjellat e përhershme, të mbjellat që janë në këmbë, dhe kështu me radhë. Kjo llogaritje e detajuar do të ndahet me palët e prekura, Qeverinë dhe komunat relevante. Nëse njësitë familjare të prekura pranojnë vlerësimin, Autoriteti i Shpronësimit do të kërkojë miratimin e PVR-së.

Nëse pala e prekur nuk e pranon vlerësimin apo beson se asetet janë shmangur ose nënvlerësuar dhe nuk mund të arrijë një marrëveshje mbi vlerësimin përmes kësaj Kornize të Politikës së Risistemimit, pala e prekur mund të bëjë një ankesë tek komisioni i pavarur për shqyrtim të ankesave të pretenduara, i cili mund të krijohet për të mbuluar të gjitha aspektet e projektit. Nëse pala nuk është e kënaqur me vendimin e Komisionit, vlerësimi për atë pronë të patundshme në veçanti nuk do t'i

nënshtrohet kësaj kornize dhe procedura e shpronësimit do të fillojë sipas Ligjit për Shpronësim të Pronës së Patundshme Nr. 03 / L-139.

Autoriteti i Shpronësimit do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet e ndërlidhura me implementimin e planit të risistemimit, duke përfshirë shpenzimet e anketimit, vlerësimit, kërkimeve të regjistrit të tokës, përgatitjen dhe sigurimin e hapësirës për zhvendosje, çdo shpenzim tranzicional, duke përfshirë vonesën e disponueshmërisë së strehimit të risistemimit dhe kështu me radhë.

Autoriteti i Shpronësimit do të jetë përgjegjës për sigurimin e kompensimit për çdo vonesë të arsyeshme dhe vonesat e tilla do të specifikohen në PVR.

### **Hapja, konsultimet publike dhe pjesëmarrja**

Drafti final i kësaj KPR-je do të publikohet në ueb faqen e INFRAKOS në mënyrë që të fillohet me konsultimet publike me palët e interesuara para miratimit të tij.

Dispozitat e kësaj KPR-je do të përditësohen / modifikohen kohë pas kohe bazuar në përvojën gjatë implementimit, siç nevojitet.

Njëri nga qëllimet e INFRAKOS-it duhet të jetë që të krijojë kanale efektive të komunikimit në mes të familjeve të prekura, autoriteteve lokale dhe kombëtare.

Në rast të identifikimit të shpronësimit në faza të mëvonshme, çdo PVR specifik po ashtu do të jetë i hapur në mënyrë të njëjtë për të pranuar komente dhe sugjerime. Detajet e kriterëve, opsioneve dhe procedurave nga plani i risistemimit do të publikohen plotësisht. Secili draft i PVR-së do të jetë i hapur për një apo më shumë konsultime publike për një afat 30 ditësh dhe do të jetë i hapur publikisht në adresën e INFRAKOS-it dhe në dispozicion në zyrat e komunave lokale.

Pasi që në fazën e përgatitjes së PVR-së për një segment specifik të gjitha faktet të ndërlidhura me shpronësimin eventual do të jenë të njohura, konsultimi publik me të gjithë personat e prekur nga projekti dhe përfaqësuesit e komunave do të koordinohet nga INFRAKOS. Informacioni i detajuar për konsultimin publik do të inkorporohet në PVR.

### **Krijimi i komisionit të ankesave për vlerësimin e dëmshpërblimit**

Objektivi i komisionit të pavarur të ankesave është që të ofrojë udhëheqje / këshillë dhe të merret me çdo pakënaqësi / ankesë të ndërlidhur me çdo shpronësim apo risistemim nën këtë skemë. Sfera e përgjegjësisë së komisionit të pavarur për ankesa përfshinë përgjegjësinë për të ndërhyrë në çdo mosmarrëveshje në krahasueshmërinë e tokës bujqësore të ofruar, ose vlerës së drejtë të vlerësuar për pronën e patundshme, mospërputhjet në matjet, mospagesat e kompensimit dhe asistencës, pranueshmërisë për përfitime nën KPR dhe çështjet tjera të ndërlidhura. INFRAKOS-i do të përcjell çdo ankesë tek Komisioni për Ankesa.

INFRAKOS-i mund të krijojë një komision të pavarur të ankesave që përbëhet nga përfaqësuesit e INFRAKOS-it, përfaqësuesit komunal (të deleguar nga komuna), përfaqësuesit e personave të prekur nga projekti dhe një person i respektuar në komunë që përfshinë personat e prekur nga projekti si përfaqësues i komunitetit, nëse delegohet nga personat e prekur nga projekti. Formimi i komisionit të ankesave do të bëhet në kohën e finalizimit të PVR-së. Nëse pas ndërhyrjes, personi i prekur nga projekti, që i është ofruar tokë bujqësore e krahasueshme apo vlerësuar me shumë të drejtë për pronën e patundshme; konteston qoftë krahasueshmërinë apo vlerësimin e vlerës së drejtë, ata janë të lirë që të fillojnë proces gjyqësor në një mënyrë të përputhshme me ligjin aktual mbi shpronësimin.

## **Monitorimi**

INFRAKOS do të monitorojë implementimin e procesit të risistemimit përmes rregullimeve të brendshme zyrtare institucionale dhe duke u bazuar në këtë KPR dhe legjislacionin tjetër ekzistues në Kosovë.

## **Orari dhe buxheti**

### **Orari dhe buxheti i integruar**

Projekti pritet të ndërmerret në tri faza, siç vijon: (i) Fushë Kosovë – Hani i Elezit 2016 – 2018; (ii) Fushë Kosovë - Mitrovicë 2017- 2019; dhe (iii) Mitrovicë – Leshak 2018 - 2020. Gjatë dizajnit të projektimit të detajuar të secilës fazë, konsulentët ndërkombëtarë të rekrutuar do të përgatisin një vlerësim mjedisor dhe social i cili do të identifikonte risistemimet e pavullnetshme, nëse ka, përmes anketimeve të detajuara në terren. Në rast se risistemimi i pavullnetshëm është i nevojshëm, një Plan Veprimi i Risistemimit, në pajtueshmëri me këtë Kornizë, do të përgatitet dhe implementohet nga promotori.

Një orar i detajuar për implementimin e një programi të risistemimit do të zhvillohet si pjesë e secilit PVR. Do të zhvillohet një bashkëpunim i afërt me planifikuesit e projektit, duke marrë në konsideratë kohën e propozuar të fazave të ndryshme të kompletimit.

### **Orari dhe buxheti i llogaritur**

Orari dhe buxheti i llogaritur për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore duhet të zhvillohet në bashkëpunim të afërt me planifikuesit e INFRAKOS-it, duke marrë në konsideratë kohën e propozuar të fazave të ndryshme të rehabilitimit të linjës hekurudhore. Çështja më kritike në këtë fazë është përgatitja e PVR-së për fazën e parë të rehabilitimit të linjës.

## **Shtojca A: Skica e një plani të veprimi të risistemimit**

### **1. Hyrje**

- Emri dhe adresa e organit kërkues
- Vendndodhja e projektit (me harta të detajuara)
- Përshkrimi dhe historia e projektit dhe punët e ndërlidhura
- Analizat e alternativave për secilin përbërës (linja, transporti, qasja në rrugë/hekurudhë, ndërtesat e stacionit, deponia e hirit apo pellgu i hirit, etj) që shfaqin se alternativat janë zgjedhur për të minimizuar risistemimin, por pa rrezikuar sigurinë publike
- Institucionet e përfshira në projekt (zonat e përgjegjësisë)
- Pjesëmarrja e agjencive lokale, organizatave të njerëzve të prekur
- Statusi aktual i projektit
- Çështjet e jashtëzakonshme

### **2. Studimet socioekonomike bazë dhe definicionet**

- Zonat e prekura direkt dhe indirekt nga projekti dhe punët përcjellëse duke përfshirë përcaktimin e zonave të sigurisë në mes të punëve dhe popullsisë më të afërt
- Informacioni i saktë për njerëzit e prekur direkt sipas kategorisë: humbje e tokës dhe strehimit (pronarët/qiramarrësit), humbja e strehimit (pronarët/qiramarrësit), humbja e tokës (pronarët/qiramarrësit, marrësit e pronës përgjysmë, të tjerë), humbje tjetër e të ardhurave, treg i shitjes me pakicë, ndërmarrje të vogla, etj), grupe të tjera të prekura. Kjo duhet të përmblihet në tabela
- Përcaktimet kryesore: afatet e fundit, përdorueshmëria e zonave pjesërisht të prekura, përcaktimi i njësisë familjare, kriteret e përdorura për të përcaktuar përshtatshmërinë për llojet e ndryshme të përfitimeve të risistemimit
- Identifikimi i çdo grupi të pambrojtur (njerëz apo refugjatë të zhvendosur përbrenda, grupe etnike, punëtorë të patokë, gra krye shtëpiake, etj)
- Mbajtje e tokës e popullsisë së prekur (pronarë privat, tokë në pronësi publike, sipërfaqe toke komunale ose e fshatit, tokë e përbashkët, qiramarrësit, marrësit e pronës përgjysmë, etj. – identifikoj çdo çështje që mund të prek të drejtën mbi tokën apo njësinë familjare, për shembull, transaksionet apo trashëgimitë ilegale, taksat e papaguara, pronat që janë braktisur gjatë luftës – përfshirë konsideratën për të drejtat e grave kryeshtëpiake dhe grave që jetojnë në bashkësitë me ligj zakonor)
- Prodhimi bujqësor, bagëtitë, të hyra tjera në fermë
- Çdo aset i përbashkët produktiv që mund të preket (kullosat komunale, pylli i përdorur për mbledhjen e drunjëve për zjarr, lumenjtë dhe liqenet e përdorura për peshkim, etj.)
- Aktivitetet tjera ekonomike – çdo punësim lokal që mund të preket
- Nivelet e llogaritura të të hyrave dhe shpenzimeve (duke përfshirë kostot mesatare për shërbimet bazë: uji, kanalizimi, energjia, dhe taksat lokale)
- Infrastruktura sociale dhe e transportit (shkollat, vendet e shëndetit dhe qendrat e shëndetit, xhamitë, kishat, varrezat, qasja në rrugë, urat, etj)



### 3. Korniza Ligjore dhe Institucionale

- Baza ligjore, fushëveprimi dhe procedurat për përvetësim të tokës
- Përgjegjësia e sponzorëve të projektit
- Roli i autoriteteve qeveritare dhe lokale në përgatitjen dhe implementimin e planit të risistemimit
- Përgjegjësia për pagesën e kompensimit dhe risistemimit
- Vlerësimi & kompensimi i tokës dhe pronës
- Mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe problemeve mbi tokën apo titujt e shtëpisë
- Autoriteti për shpronësim dhe procedurat e miratimit
- Komunikimi dhe koordinimi me autoritetet lokale, OJQ-të dhe organizatat e njerëzve të prekur
- Procedurat për menaxhimin e ankesave dhe arbitrimi
- Përgjegjësia për monitorim dhe vlerësim

### 4. Kompensimi dhe rehabilitimi

- Kriteret e pranueshmërisë për kompensim (afatet e fundit, titujt informal dhe ilegal, qiramarrësit afatgjatë dhe banorët tjerë)
- Opsionet e kompensimit për humbje të tokës (humbje totale, humbje të pronave të zbatueshme, humbje të pjesërishme, përkufizime në shfrytëzim, siç janë mbushje rezervuari, linja transmetimi)
- Kompensim për humbje të strehimit (pronarët, qiramarrësit, banorët, tjerë)
- Përshkrimi i detajuar i tokës së propozuar për kompensim në tokë dhe para, duke përfshirë zgjedhjet dhe faktorët që mund të prekin zgjedhjet dhe çdo problem të mundshëm siç janë borxhet, hipotekat apo taksat a papaguara të tokës
- Përshkrimi detaj i strehimeve të propozuara dhe zgjedhjet e shërbimit, me një analizë të zgjedhjeve të preferuara të mundshme dhe çdo problem të mundshëm (kostot e sigurimit të shërbimit, mirëmbajtja, stili i strehimit)
- Procedurat, metodologjia dhe përgjegjësia për vlerësimin e tokës, pronës dhe procedurat e aseteve tjera për pagesën e kompensimit dhe kohën për kompensim
- Procedurat e zgjidhjeve të kontesteve
- Kompensimi për humbjen e përkohshme të të ardhurave dhe të mbjellave mjete jetese për fermat, tregjet me shitje me pakicë dhe bizneset tjera (vlerësimi, kompensimi, koha, zgjidhja e kontesteve)
- Procedurat, përgjegjësia për vlerësimin e humbjeve të të hyrave, kompensimi, koha, dhe zgjidhja e kontesteve
- Programet për trajnim dhe zhvillim institucional
- Kompensimi për humbjen e infrastrukturës sociale dhe/ose të transportit dhe njësive të trashëgimisë sociale dhe/ose kulturore (xhamitë, kishat, varrezat, monumentet e luftës, etj)
- Ndikimi i familjeve të prekura, në popullsinë “mikpritëse”, dhe masat për të shmangur çdo konflikt të mundshëm
- Objektet për të akomoduar kërkesën nga fluksi i punëtorëve të ndërtimit (shërbimet mjekësore, shkollimi, etj)

## **5. Transporti dhe çështjet tjera tranzicionale**

- Rregullimet për të lëvizur njësitë familjare të prekura në vende të reja (transporti, akomodimi i përkohshëm, transporti i mobilieve, pajisjeve, bagëtimeve etj)
- Koha e lëvizjes, në veçanti në lidhje me ciklin bujqësor dhe vitin shkollor

## **6. Lehtësimi Mjedisor**

Kjo i referohet ndikimeve mjedisore të programit të risistemimit, dhe jo ndikimeve që shkakton risistemimi, dhe përfshinë:

- Ndikimet e programit strehimor, duke përfshirë ndikimet e ndërlidhura me ndërtimin dhe ndikimet afatgjate, në veçanti në burimet dhe përdorimin e ujit, kanalizimin, drenazhin rrugor, hedhjen e mbeturinave të ngurta
- Ndikimi i mundshëm i popullsisë së risistemuar në shërbimet lokale (shëndeti, shkollimi)
- Ndikimi i popullsisë së risistemuar në popullsinë lokale (në veçanti çdo grup i pambrojtur)
- Ndikimi i burimeve natyrore siç janë mbledhja e drunjëve për zjarr, peshkimit, etj
- Ndikimi i projekteve të rivendosjes së të hyrave: programet bujqësore dhe të bagëtisë (shpyllëzimi, mundësi për erozion të tokës, shfrytëzim të kemikalieve bujqësore); industrinë e vogla (shfrytëzimi i ujit, mundësi për ndotje)
- Menaxhimi mjedisor dhe plani i edukimit për programin e risistemimit
- Çdo plan për të siguruar strehim, infrastrukturë apo shërbime sociale për anëtarët e popullsisë mikpritëse të prekur nga fshatrat e risistemuara

## **7. Konsultimi publik dhe procedurat e ankesave**

- Konsultimi, hapja publike dhe procedurat e komunikimit social
- Përgjegjësia institucionale për konsultim dhe komunikim
- Përshkrimi i konsultimeve të kryera për të përgatitur planin e risistemimit dhe orari për aktivitetet e të ardhmes
- Palët e përfshira në konsultim publik
- Masat për tu siguruar që grupet e pambrojtura janë konsultuar plotësisht
- Shqyrtimi, përmbledhja dhe zbulimi i rezultateve të konsultimit dhe si janë integruar ato në planifikimin e risistemimit
- Mekanizmat e propozuar për regjistrimin dhe zgjidhjen e ankesave

## **8. Orari dhe përgjegjësitë për implementimin e planit të risistemimit**

- Koha e studimeve bazë dhe regjistrimit, vlerësimi i tokës/pronës/të mbjellave/humbjes së të ardhurave, pagesa e kompensimit, risistemimi, rehabilitimi, rindërtimi i infrastrukturës sociale etj (kjo duhet të përgatitet si një grafik Gant dhe duhet të jetë i lidhur me kohën e punëve civile dhe aktiviteteve përcjellëse)
- Grafik i cili shfaq përgjegjësitë institucionale për secilin përbërës të planit të risistemimit, shtegun vendimtar dhe kohën

## 9. Kostot

- Kosto e llogaritur për secilin përbërës dhe nën-përbërës të planit të risistemimit (përvetësimi i tokës dhe kompensimi, njësia familjare, infrastruktura sociale, rehabilitimi ekonomik, trajnimi)
- Kosto e llogaritur për secilin përbërës, të ndara nga muaji/viti i pritur i shpagimit
- Kosto e llogaritur për secilin përbërës dhe nën-përbërës, të ndara nga institucioni përgjegjës dhe muaji/viti i pritur
- Shpenzimet operative, nga institucioni, dhe me muaj/vit (shpenzimet e stafit, shpenzimet e zyrës dhe të funksionimit, transporti)
- Analizat e kostove të kompensimit dhe risistemimit si proporcion i kostove të përgjithshme të projektit

## 10. Monitorimi dhe vlerësimi (M&E)

- Përgjegjësitë për M&E
- Procedurat e raportimit
- Treguesit për M&E (strehimi/shërbimet, treguesit ekonomik, shëndeti, shkollimi)
- “Paneli i ekspertëve” opsion për të shqyrtuar dhe këshilluar në çështje specifike.
- Vlerësimi i rezultateve aktuale